



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURRENCËS-
Komisioni i Konkurrencës

VENDIM

Nr. 135 , datë 21.12.2009

“Për

**hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimeve të
automjeteve të reja”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- | | | |
|-----------|-------------|---------|
| • Lindita | MILO (LATI) | Kryetar |
| • Servete | GRUDA | Anëtar |
| • Koço | BROKA | Anëtar |
| • Rezana | KONOMI | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 21.12.2009, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimeve të automjeteve të reja, për ekzistencën ose jo të marrëveshjeve në oferta që kufizojnë konkurrencën në këtë treg.

Baza ligjore: Neni 4, neni 24, shkronja d, neni 26 dhe neni 43, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe nenet 12 dhe 12/1 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të Raportit “Mbi hetimin paraprak në tregun e prokurimeve të automjeteve të reja” të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, dhe Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

Nga hetimi paraprak në tregun e prokurimeve të makinave të reja rezultoi se ekzistojnë evidenca, në formë elektronike dhe shkresore, të bashkëpunimit midis 4 ndërmarrjeve Classik Sh.p.k, Ultramotors Sh.p.k, Noti shpk dhe Hyundai shpk për pjesëmarrje në prokurimet publike, çka mund të përbëjë një praktikë të bashkërenduar ndërmjet ndërmarrjeve që veprojnë në tregun përkatës.

Ndërmarrjet përdorin skemën e ofertave të mbuluara, duke pranuar për të ofertuar me lart se sa oferta e fituesit të zgjedhur, si dhe njeri nga konkurrentet pranon të ofertojë me një vlerë e cila është shumë e madhe për tu pranuar si fituese.

Nga hetimi paraprak është konstatuar se dokumentat e dorëzuara nga Autoritetet Kontraktore mbi ofertat e Classik Sh.p.k, Ultramotors Sh.p.k, Noti Sh.p.k dhe Hyundai Sh.p.k, të cilat janë vlerësuar edhe në bazë të Metodologjisë “Për luftën

ndaj koordinimit të ofertave në prokurimet publike” kanë gabime të njëjta ortografike, çka mund të përbëjë një element të mundshëm të koordinimit të sjelljes.

Eshte vënë re se ndërmarrjet rrisin vlerën e ofertës fituese nga 95%–99%, pra afër fondit limit, që mund të vijë si rrjedhojë e bashkëpunimit. Në tenderat ose lotet ku pjesmarrja është më e madhe se këto katër ndërmarrje, ofertat fituese rezultojnë 83% – 86 % te fondit limit.

Rrezultatet e hetimit paraparak tregojnë për mundësinë e ekzistencës së një sjelljeje të bashkërenduar në kuptim të nenit 3, pika 4 dhe nenit 4 të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” mes ndërmarrjeve “Hyundai” Shpk, “Utra Motors” Shpk, “Classic” Shpk, dhe “Noti” Shpk në tregun përkatës të makinave të reja të prokuruar me fonde publike.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d) dhe nenit 43, pika 1, , të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe në nenin 12 dhe nenin 21, pika 4, te Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

V E N D O S I:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimeve të automjeteve të reja ndaj ndërmarrjeve:
 1. Classic Sh.p.k;
 2. Ultramotors Sh.p.k;
 3. Noti shpk;
 4. Hyundai Auto Albania shpk,me objekt ekzistencën ose jo të marrëveshjeve në oferta që kufizojnë konkurrencën në tregun e prokurimit të automjeteve të reja.
- II. Hetimi i thelluar të përfshijë periudhën kohore nga 01 Janar 2007 deri në 20 dhjetor 2009.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

(_____)

Anëtar

Koço BROKA

(_____)

Anëtar

Rezana KONOMI

(_____)

Anëtar

Lindita MILO (LATI)

KRYETARE